



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA “ALBPETROL” SHA
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

Patos më, ____ .10.2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Update programi kompjuterik per menaxhimin e magazinave dhe paisja e tyre me barcod”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 72200000-7 - Programim te programeve kompjuterike dhe konsulence,

VLERA E FONDIT LIMIT: 19,553,333 (nëntëmbëdhjetë milion e pesëqind e pesëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë) lekë pa TVSH.

Bazuar në nenin 39 të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” parashtrojmë arsyet kryesore për vendimin e mosndarjen në lote për këtë procedurë.

Objekti i prokurimit është konceptuar si një i tërë dhe për këtë arsye është e pamundur të ndahet në lote.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Albpetrol sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1. Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP dhe ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si dëshmi për pervojën e mëparshme kërkohej të paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.

OSE

Ne rastin e pervojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë pervojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 ose e përditësuar mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente (e vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtyre kërkesave AK kërkon të sigurohet që ofertuesit ushtrojnë aktivitetin dhe janë të certifikuar në përputhje me kërkesat e menaxhimit të cilësisë dhe ky kriter i vendosur është në përputhje të plotë me objektin e prokurimit.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë ISO 27001:2013 ose e përditësuar për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtyre kërkesave AK kërkon të sigurohet që ofertuesit ushtrojnë aktivitetin dhe janë të certifikuar në përputhje me kërkesat e menaxhimit të sigurisë së informacionit dhe ky kriter i vendosur është në përputhje të plotë me objektin e prokurimit.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë 20000-1:2018 ose e përditësuar për Menaxhimin e sistemeve të informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtyre kërkesave AK kërkon të sigurohet që siguron që operatori ekonomik ka të implementuar një sistem ofrimi të shërbimit përmes të cilit efektivisht planifikon, zhvillon, implementon, operon, monitoron, kontrollon dhe mirëmban portofolin e shërbimeve dhe cilësinë e tyre.

2.3.5. Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i certifikuar për teknologji të mëposhtme:

- Sisteme ERP të Aseteve dhe Inventareve;
- Infrastructure Cloud;
- Sisteme të inventareve (Supply Chain)

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikimet e marra nga prodhuesit e programeve dhe teknologjive.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Sistemet kryesore në projekt janë Cloud ERP; Lidhur me zbatimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të mësipërme, prodhuesit e programeve informatike të mirënjohur ndërkombëtare apo edhe të ngjashëm, kanë ndërtuar programe trajnimi dhe kontrolli të shoqërive të cilat mundet të kryejnë shërbime që lidhen me zbatimin apo mirëmbajtjen e këtyre sistemeve. Në kuadër të këtyre programeve prodhuesit vendosin kritere teknike; organizative për procedurat e brendshme të shoqërive. Këto programe/kushte ndërtohen nga vetë prodhuesit dhe ata në këtë mënyrë marrin përsipër cilësinë e shërbimeve të ofruara nga shoqëritë. Në shumë raste, kalimi i certifikimeve i kualifikon shoqëritë e IT si të autorizuar apo jo prej tyre për realizimin e shërbimeve të nderhyrjes, përmirësimit apo përditësimit të sistemeve. Nëse shoqëritë nuk kanë certifikime të prodhuesit (për sisteme apo modulet) çdo nderhyrje në sistem rrezikon perfundimin e kushteve të garancisë apo të mirëmbajtjes së prodhuesit.

Pra, certifikimet e mësipërme që kanë lidhje me Modulet apo sistemet që kërkohet të prokurorët jo vetëm që përbejnë një nevojë për garantimin e cilësisë së shërbimit, por ato janë direkt të lidhura edhe me kërkesat e prodhuesve për mirëmbajtjen. Nderhyrje në sistem nga shoqëritë të pa-certifikuara mundet të demotojë vetë sistemin, të dhenat që mbahen në sistem dhe/ose në kuadrin e sigurisë së informacionit mundet të behet shkak për aksesin apo demtimin e informacionit në persona apo drejtime të paautorizuara.

Në projektin në fjalë sistemet kryesore ERP të kërkuara janë ato Aseteve dhe Inventareve, të cilat kanë specifika të vecanta, ndaj edhe në certifikimin e OE kërkohet që ai të njohë dhe zotërojë njohuritë specifike që lidhen me administrimin e inventarit, rrjedhës së proceseve (supply chain).

Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për të garantuar që Operatori Ekonomik ka mbështetjen e prodhuesit për të garantuar cilësinë e produkteve dhe furnizimin e tyre në kohë për përmbushjen me sukses

të kontratës, duke garantuar funksionimin e sistemeve në kushtet e garancisë dhe pas saj. Certifikimet e mesipërme, garantojnë autoritetin Kontraktor që shërbimet e përfshira në kontratë do të levrohen janë në përputhje me kërkesat e shoqërive prodhuese

2.3.6. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se 5 (pesë) punonjës, ku të përfshihet personel me certifikime si vijon:

- 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim projekt
- 1 (një) punonjës të certifikuar për sistemin e Aseteve dhe inventarit
- 1 (një) punonjës të certifikuar për sisteme infrastrukturë cloud
- 1 (një) punonjës të certifikuar për administrator databazë për administrimin e bazës së të dhënave
- 1 (një) punonjës të certifikuar për sisteme të raportimit BI

Shënim: Një punonjës mund të ketë më shumë se një certifikatë.

Për secilin punonjës të paraqiten:

- Certifikatat përkatëse.
- Listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit, ose kontrata e shërbimit me afat jo më të shkurtër se periudha që do të ofrohet shërbimi që prokurohet e shoqëruar me certifikatën përkatëse nëse specialistët janë të kontraktuar.

Shënim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Ky numër punonjësish konsiderohet optimal për shërbimin e kërkuar objekt kontrate.

1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim projekt

Për mirë menaxhimin e kontratës dhe sigurinë që të përmbushen detyrimet kontraktuale, është e domosdoshme prezencën e një menaxheri projektesh të certifikuar.

1 (një) punonjës të certifikuar për sistemin e Aseteve dhe inventarit

Implementimi i sistemeve Asete dhe Inventareve, kërkon njohuri specifike për cilat lidhet jo vetëm me njohjen e sistemeve ERP por edhe me njohjen e praktikave dhe operacionale të ndërmarrjeve. Certifikimi i këtij lloji garanton OE që sistemi do të zbatohet nga personel teknik që ka kaluar kushtet e prodhuesve për specialiste të këtij lloji. Këto njohuri janë specifike dhe të domosdoshme për zbatimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve.

1 (një) punonjës të certifikuar për sisteme infrastrukturë cloud

Ky projekt kërkon që shërbimet të marra të jetojnë në Cloud dhe për këtë është e nevojshme që të jetojnë pjesë e stafit të kësaj specializimi në cloud. Këto njohuri janë specifike dhe të domosdoshme për zbatimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve.

1 (një) punonjës të certifikuar për administrator databazë për administrimin e bazës së të dhënave

Ky projekt kërkon që të dhënat të jenë të ruajtura në baze të dhënash. Për këtë është e nevojshme që të jetë pjesë e stafit të paktën një person që ka akses në “database”.

1 (një) punonjes të certifikuar për sisteme të raportimit BI

Implementimi i projektit, kërkon njohuri specifike në fushën e BI. Certifikimi i këtij lloji garanton OE që sistemi do të zbatohet nga personel teknik që ka njohuri për këtë teknologji.

2.3.7. Operatori ekonomik duhet të paraqes autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për shërbimet objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit. Në autorizim duhet të jetë i paraqitur numri i referencës së procedurës së prokurimit si dhe të dhëna të sakta të Prodhuësit/Distributorit (Adresë, website, email, telefon) në mënyrë që AK të ketë mundësi të kryej verifikimet nëse do të nevojitet.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77, pika 2 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pikën 6, të nenit 41 dhe nenin 44, pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Suporti i prodhuesit/distributorit të autorizuar, është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e suportuesve që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre shërbimeve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të shërbimeve që kërkohen të blihen e që janë krijuar me standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushje me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës të cilët kanë njohuri të posaçme për objektin e prokurimit.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njesia e prokurimit: